



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1306 prot.

Roskovec, më 18.02.2023

VENDIM

Nr. 20, datë 27.02.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 98,  
DATË 23.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT, NUMRIT MAKSIMAL TË  
PUNONJËSVE TË BASHKISË DHE TË NDËRMARJEVE VARTËSE TË BASHKISË PËR  
VITIN 2023”

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh” të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, si dhe shkresës së Ndërmarrjes së Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza Nr.55 datë 16.02.2023 protokolluar në institucionin tonë me Nr.1023, datë 16.02.2023, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, si më poshtë vijon:
  - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2023 nga **353 (treqind e pesëdhjetë e tre)** punonjës të përhershëm bëhet **358 (treqind e pesëdhjetë e tetë)** punonjës të përhershëm. Konkretisht shtohen në organikën e Ndërmarrjes së Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza **5 (pesë)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për Ndërmarrjen e Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza ndryshon nga **82 (tetëdhjetë e dy)** bëhet **87 (tetëdhjetë e shtatë)** punonjës të përhershëm.
2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2023.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Ndërmarrja e Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR  
Kadri Hyska

